



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIEVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jediniça Org.Unit	APPL
Nr. i Faqeve Be Stranica No. Pages	1
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No	3405-2/24
Datim: Datum: Date	27-12-24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	27.12.2024
REFERENC-Ë:	3405/24 ZSP - 2024
PËR/ZA/TO:	Drejtoria e Sherbimeve Publike, K. PRIZREN
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Afrim MURATI, U.D. Sekretar i të Përgjithshëm të MMPHI-së; Z. Agron SHALA, U.D, Drejtor i ARPI-së; Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Pëlqim ujq

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, bazuar në kërkesën me Nr. Protok. 3405/24, datë 23.05.2024 lidhur me projektin "Rregullimi i shtratit të Lumbardhit të Prizrenit nga Ura afër Kampusit në vazhdim të rrjedhës në gjatësi prej $L = 3.3$ Km", pas shqyrtimit të lëndës dhe shikimit në vend, ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. PU

Datë: 27.12.2024

Sekretari i Përgjithshëm, i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës dhe nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurat e Përgjithshme Administrative, si dhe dispozitave ligjore të U.A. MMPH- Nr. 03/2018 Për procedurat për Leje Ujore, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa për Pëlqim Ujor për palën, Drejtoria e Sherbimeve Publike, K. Prizren, me nr. Protok. 3405/24, për projektin "Rregullimi i shtratit të Lumbardhit të Prizrenit nga Ura afër Kampusit në vazhdim të rrjedhës në gjatësi prej L= 3.3 Km" nën kushtet si në vijim:

1. Pëlqimi Ujor lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv, bazuar në pikat gjeodezike, në distancë L=3.3 Km, pika e fillimit me koordinata (X=7 477 213.021; Y=4 674 227.33), deri te pika e mbarimit (X= 7 474 609.61; Y= 4 672 805.15), si dhe bazuar në profilet karakteristike tërrthore të Lumit, sipas llogarive, si pjesë përbërëse e dokumentacionit, në bazë të së cilave është hartuar vendimi, andaj si i tillë ruhet nga pala, nën kushtet si në vijim:
2. Projekti duhet realizuar vetëm për gjatësinë e kërkuar, L = 3.3 Km, të hartuar nga kompania hartuese e përzgjedhur nga K.Prizrenit, si dhe bazuar në periudhat e kthimit të përmytjeve 100 vjeçare, nën mbikqyrjen e plotë të zyrtarëve profesional komunal, të K. Prizren;
3. Pëlqimi ujon jepet për rregullimin – rehabilitimin e murrit përgjatë shtratit të Lumit , si dhe pastrimin nga mbeturinat, bazuar në llogarit për pastrimin, deri sa të plotësohen



kushtet e eliminimit të përmbytyjeve, të llogaruara si në projekt, dhe kjo bëhet nën mbikqyrje të plotë të K. Prizren dhe në harmoni me legjislacionin për ujërat e Kosovës dhe ka afat një vjeçar;

4. Pëlqimi ujqor për nxjerrjen e materialit ndërpritet edhe para afatit të përcaktuar nga paragrafi si më sipër, nëse gjatë kontrollit nga inspektorati i ujërave komunal dhe qendrorë, vërtetohet se kryesi i punëve nuk iu është përmbytur kushteve të përcaktuara me pëlqim ujqor;
5. Dinamika e nxjerrjes së materialit, dhe rehabilitimi pas këtijë aktiviteti të prezantohet në formë ditari për secilin segment, nëse është has në material të karakterit, rërë , gurrë dhe zhavorr, në MMPHI;
6. Raportet duhet të jenë të nënshkruara dhe me datë, në ditën kur janë kontrolluar nga organi mbikqyrës i Komunës së Prizrenit, sipas legjislacionit të ujërave në fuqi;
7. Pastrimi i dërrunjëve duhet të kryhet në harmoni me pëlqim nga organi përgjegjës, APK –ja e cila ka njësit e veta nëpër komuna, dhe duke u bazuar ne ligjin për pyjet e Kosoves , pra ligji nr. 03/l-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës;
8. Nëse vie deri te prishja e regjimit të ujërrjedhës, ose i shkaktohet dam palës së tretë gjatë realizimit të punimeve, punkryesi detyrohet që dëmet ti eliminoj dhe të njejtat ti kompenzoj;
9. Pëlqimi ujqor për nxjerrjen e materialit nga ujërrjedha vlenë për vitin aktual në të cilin është lëshuar pëlqimi ujqor, respektivisht në harmoni me dinamikën nga elaborati për nxjerrjen e materialit nga ujërrjedha.

ARSYETIM

Pala, Komuna e Prizrenit–Drejtoria e Shërbimeve Publike, ka aplikua për Pëlqim Ujqor, me kërkesë Nr. 3405/24, datë 23.05.2024, për projektin “Rregullimi i shtratit të Lumbardhit të Prizrenit nga Ura afër Kampusit në vazhdim të rrjedhës në gjatësi prej L= 3.3 Km” dokumentacionit tekniko investiv i ka bashkangjitur- Studimi hidrologjik dhe hidraulik i Lumbardhit të Prizrenit; Analiza e Rrjedhes së përmbytyjes; rreshjet sipas formule montana; Lakorja e frekvences së kohëzgjatjes së intensitetit, Prizren; si lakorja e qendrueshmerisë së rrjedhes në Lumbardhin në Prizren; Analiza Hidrologjike; : Pagesën e tarifës me rastin e aplikimit për pëlqim ujqor , në vlerë prej 2000 € (dymijë euro), me nr serik te fatures 000089, datë 17.05.2024; Njoftim për plotësim të dokumentacionit, me nr 04-353/01-163343, dt. 08.02.2024, nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, K. Prizren; Certifikatën e pronësisë për ngastren me nr. P-71813068-11041-0, Pasuri Shoqërore e Ujërave; Kopje e planit të P-71813068-11041-0, Pasuri Shoqërore e Ujërave; ”Studimi Hidrologjik dhe Hidraulik i Lumbardhit të Prizrenit” për rregullimi i shtratit të Lumbardhit të Prizrenit, nga Ura afër Kampusit në vazhdim të rrjedhës në gjatësi prej L= 3.3 Km; Certifikata e regjistrimit të biznesit të kompanisë hartuese N.SH. “Smart Architecture”; Certifikata e TVSH –së; Diplomë e hartuesit Rijad Njazi Zejneli – Master i shkencave teknike, programi: Hidroteknika

Vërejtje:



Ky projekt do të realizohet, me qëllim të mbrojtjes së regjimit të ujërave, shtratit dhe brigjeve të lumit, pastrimin e mbeturinave nga trupi ujqor sipërfaqësorë në segmentin e caktuar, si dhe

Nenit 46 (Ligji 04/L-147 për Ujërat e Kosovës mbrojtjen - Kompetencat për mbrojtje nga vërshimet e dëmshme të ujërave;

1. Kompetent për mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe
 2. mbrojtjen nga erozioni dhe veprimet tjera të dëmshme në zona urbane, zona e kufijve të qytetit, është **komuna**.
- Bazuar në udhezimit administrativ nr.04/2016 për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulacioneve, neni 3, paragrafi 1.2, përgjegjësi për zonën urbane e cakton komunën;
 - Sa i përket prerjes së drunjëve, nëse në ndonjë rast paraqitet e domosdoshme atëherë vepohet sipas legjislacionit në vijim :
 - APK –ja , në komuna ka njësit e veta dhe duke u bazuar në ligjin për pyjet e Kosovës , pra ligji nr. 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës;

Neni 12 (Ligji nr .03/1-153)

- Mbrojtja e pyjeve si kompetencë delegohet nëpër komuna: a) shërbimi i mbrojtjes së pyjeve në tërësi në pajtim me nenin 29.1, 29.2, dhe 29.3 të kapitullit VIII të ligjit për Pyjet e Kosovës kalojnë si **kompetencë komunale**;
- 29.7. Mbrojtja e pyjeve dhe dhënia e licencave për prerjen e drunjtëve në territorin e komunës përcaktohet si kompetencë e deleguar sipas nenit 18 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale”
- Poashtu K. Prizren deklarohe se, pastrimi i shtratit të lumit është më se i nevojshëm pasi që janë bartur mbeturina të shumta brigjeve të tijë e të cilat po pengojnë rrjedhën e ujit dhe në raste të vërshimeve, ato po depërtojnë në tokat bujqësore, duke ndotur tokën si dhe oborret e shtëpive afër shtratit;

Andaj bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike K. Prizren, dokumentacionit – investivo teknik të hartuar, poashtu interesimi që ka shprehë Komuna për rregullim të gjendjes aktuale si dhe shikimit në vend, me datë 10.10.2023, ku edhe nga zyrtaret janë bërë foto në këtë segment, ku shihet se në atë pjesë përpos mbeturinave të shumta, shkurreve, barit etj. Në segmentin e caktuar, nuk është vërejtur degradim i lumit nga deponimet e rrërs , zhavorrit apo edhe gurrëve. Me këtë rast është mbajtur edhe procesverbali i nënshkruar nga të dyja palët, përfaqësuesit të MMPHI-së dhe Komunës, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr. 3405/24 – ZSP - 2024 Datë: 27.12.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Komunës Prizren;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Arkivit të Ministrisë.

U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

